

## RELACION SHPJEGUES

### PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

#### “PËR MASËN E PAGESËS PËR FËMIJËT E VENDOSUR NË KUJDES ALTERNATIV NË FAMILJE DHE PËR FAMILJEN KUJDESTARE”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Mbështetja financiare për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje dhe paga për familjen kujdestare profesionale janë instrumente thelbësore për funksionimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë. Ligji nr. 92/2025 “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”, vendosi kuadrin e ri ligjor për këtë shërbim dhe ngarkoi Këshillin e Ministrave, me anë të nenit 31, pika 3, të miratojë me akt nënligjor masën e pagesës për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje dhe për familjen kujdestare.

Projektvendimi ka si qëllim përcaktimin e llojeve, masës, mënyrës dhe procedurës së dhënies së mbështetjes financiare për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje dhe të pagës mujore për familjet kujdestare profesionale që ofrojnë këtë shërbim, në bazë dhe për zbatim të nenit 31, pika 3 të ligjit nr. 92/2025.

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet:

- përcaktimi i mbështetjes financiare mujore për familjen kujdestare profesionale
- përcaktimi i mbështetjes financiare mujore për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje;
- përcaktimi i mbështetjes financiare vjetore për shpenzimet të tjera sipas nevojave të fëmijës;
- përcaktimi i pagës mujore për prindin aplikues të familjes kujdestare profesionale, si njohje e rolit profesional në ofrimin e kujdesit alternativ në familje dhe si garanci për qëndrueshmërinë e shërbimit, përmes punësimit pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe lidhjes së kontratës së punës në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi;
- rregullimi i procedurave për fillimin, vijimin dhe ndërprerjen e përfitimit të mbështetjes financiare dhe pagës, në lidhje me vendimin gjyqësor për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje dhe kontratën e punës të lidhur me njësinë e vetëqeverisjes vendore;
- garantimi i regjistrimit dhe administrimit të të dhënave për familjet kujdestare dhe fëmijët përfitues, si pjesë e Regjistrimit Elektronik të Kujdesit Alternativ në Familje, të integruar në regjistrin elektronik të shërbimeve shoqërore, me qëllim sigurimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit;

- parashikimi i mekanizmit të indeksimit periodik të masave të mbështetjes financiare, në përputhje me normën e inflacionit, me qëllim ruajtjen e vlerës reale të mbështetjes financiare.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave, si akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 92/2025 “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”.

Projektvendimi propozohet në funksion të zbatimit të ligjit nr. 92/2025, i cili siguron bazën rregullatore për kujdesin alternativ në familje si formën e parapëlqyer të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror. Pa miratimin e këtij akti nënligjor, që përcakton konkretisht masën e mbështetjes financiare dhe të pagës, dispozitat e ligjit në lidhje me financimin e shërbimit nuk do të mund të zbatoheshin në praktikë.

Projektakti mbështet zbatimin e prioriteteve të Programit të Qeverisë në fushën e mbrojtjes sociale dhe të drejtave të fëmijës, veçanërisht në drejtim të dezinstitutionalizimit gradual të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror dhe zhvillimit të shërbimeve të kujdesit alternativ në familje si zgjidhja e parapëlqyer. Akti është gjithashtu në harmoni me Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale dhe me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara në këtë fushë, përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ për Fëmijët, si dhe detyrimet në kuadër të integritimit në Bashkimin Evropian.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Miratimi i projektvendimit është i nevojshëm për të garantuar zbatimin e plotë dhe efektiv të ligjit nr. 92/2025 në fushën e financimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje. Pa përcaktimin e masave konkrete të mbështetjes financiare, familjet kujdestare nuk mund të regjistrohen formalisht si ofruese të shërbimit dhe fëmijët e vendosur në kujdestari nuk mund të përfitojnë mbështetjen e nevojshme financiare për përballimin e nevojave të jetesës së përditshme dhe shpenzimeve periodike.

Aktualisht, mungesa e një akti nënligjor që përcakton në mënyrë të qartë masën, llojet dhe procedurën e mbështetjes financiare krijon pengesa thelbësore për:

- zhvillimin e rrjetit të familjeve kujdestare profesionale në vend, pasi familjet kanë nevojë për qartësi mbi pagën dhe garancitë e marrëdhënies së punës para se të aplikojnë për t’u licencuar si ofruese të shërbimit;
- përballimin e nevojave bazë të fëmijëve të vendosur në kujdestari;

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për masën e pagesës për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje dhe për familjen kujdestare”.

- deinstitutionalizimin e kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror, që mund të realizohet vetëm përmes një rrjeti të qëndrueshëm dhe të mbështetur financiarisht të familjeve kujdestare.

Për këtë qëllim projektvendimi përcakton këto lloje të mbështetjes financiare:

- mbështetje mujore për shpenzimet e fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje, e diferencuar për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- mbështetje vjetore për shpenzime të tjera të veçanta sipas nevojave të fëmijës;
- mbështetje mujore për familjen kujdestare profesionale në nivelin e pagës minimale të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Efektet e pritshme nga miratimi i projektvendimit janë pozitive, pasi krijohet një kuadër i qartë financiar që garanton:

- operacionalizimin e ligjit nr. 92/2025 në pjesën që ka të bëjë me financimin e shërbimit;
- nxitjen e zhvillimit të rrjetit kombëtar të familjeve kujdestare, përmes njohjes profesionale dhe mbështetjes financiare të qëndrueshme;
- përmirësimin e cilësisë së kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare për përballimin e nevojave të tyre;
- ruajtjen e vlerës reale të mbështetjes financiare në kohë, përmes mekanizmit të indeksimit periodik për inflacion;
- transparencën dhe gjurmueshmërinë e shpenzimeve, përmes regjistrimit në Regjistrin Elektronik të Kujdestarisë Familjare të integruar në regjistrin e shërbimeve sociale, dhe raportimit periodik të Shërbimi Social Shtetëror.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektakti është në përputhje të plotë me parimet kushtetuese të mbrojtjes së veçantë të fëmijëve nga shteti (neni 54 i Kushtetutës), me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe me parimin e mbrojtjes së veçantë të personave me aftësi të kufizuara. Projektvendimi është i harmonizuar me legjislacionin në fuqi, përfshirë Kodin e Punës (në lidhje me kontratën e punës ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe prindit aplikues të familjes kujdestare profesionale), ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Projektakti është gjithashtu në përputhje me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara, përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara

për të Drejtat e Fëmijës, Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ për Fëmijët (2009).

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektvendimi në vetvete nuk synon përafrim të drejtpërdrejtë me një akt specifik të acquis-it të Bashkimit Evropian, pasi fusha e kujdesit alternativ në familje dhe financimi i shërbimeve sociale nuk janë objekt i një rregullimi të harmonizuar të detyrueshëm në nivel të BE-së. Megjithatë, projektakti kontribuon në forcimin e standardeve të mbrojtjes së fëmijës dhe shërbimeve sociale në përputhje me parimet themelore dhe instrumentet politike të Bashkimit Evropian në këtë fushë, përfshirë:

- nenin 24 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, që garanton të drejtat e fëmijës dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës;
- Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Garancinë Evropiane për Fëmijët, që promovojnë kujdesin në familje si formë e parapëlqyer e kujdesit alternativ dhe mbështetjen financiare të qëndrueshme për familjet kujdestare;
- Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale, që promovon shërbime sociale të aksesueshme dhe me cilësi të lartë për familjet dhe fëmijët;
- rekomandimet e Komisionit Evropian në kuadër të Raporteve të Progresit për Shqipërinë, në fushat e politikës sociale dhe punësimit (Kapitulli 19) dhe gjyqësorit e të drejtave themelore (Kapitulli 23).

Projektvendimi forcon kapacitetet e shtetit për të mbështetur financiarisht zhvillimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje sipas standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi përmban shtatë nene, që rregullojnë në mënyrë të plotë llojet, masën, mënyrën dhe procedurën e dhënies së mbështetjes financiare për familjet kujdestare profesionale dhe për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje.

*Llojet e mbështetjes financiare (Neni 1):* Përcaktohen tri llojet e mbështetjes financiare që rregullohen me këtë vendim: a) mbështetje mujore për familjen kujdestare profesionale; b) mbështetje mujore për shpenzimet e fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje; c) mbështetje vjetore për shpenzime të tjera sipas nevojave të fëmijës;. Ky nen vendos kornizën e përgjithshme të mbështetjes financiare që detajohet në nenet vijuese.

*Financimi për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje (Neni 2):* Përcaktohen në mënyrë të detajuar dy komponentët e financimit drejtpërdrejt për fëmijën: a) mbështetjen financiare mujore për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje për përmbushjen e

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për masën e pagesës për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje dhe për familjen kujdestare".

nevojave të jetesës së tyre të përditshme, në masën 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj;  
b) mbështetjen financiare vjetore për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alternativ në familje, për përballimin e shpenzimeve të tjera sipas nevojave të fëmijës, në masën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në vit;

*Paga për familjen që ofron shërbimin e kujdesit alternativ profesional në familje (Neni 3):* Përcaktohen rregullat për përfitimin e pagës mujore nga familjet kujdestare profesionale të regjistruara në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje. Paga përfitohet pasi prindi aplikues regjistrohet si i punësuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore me kontratë pune në përputhje me Kodin e Punës. Paga jepet për aq kohë sa familja është e regjistruar si ofruese e kujdesit alternativ profesional dhe ka në kujdestari të paktën një fëmijë. Projektvendimi parashikon mbështetjen financiare në nivelin e pagës minimale të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

*Zbatimi i masës financiare (Neni 4):* Përcaktohen rregullat operacionale për zbatimin e mbështetjes financiare. Financimi mbështetet nga buxheti i shtetit. Përfitimi i mbështetjes financiare për fëmijën dhe për familjen kujdestare profesionale fillon pas vendimit të gjykatës për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ dhe pas lidhjes së kontratës së punësimit ndërmjet familjes kujdestare profesionale dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore. Për familjet kujdestare që ofrojnë shërbim emergjence, parashikohen rregulla të veçanta për fillimin e përfitimit. Mbështetja financiare ndërpritet me përfundimin e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje. Të dhënat për familjet kujdestare dhe për fëmijët përfitues regjistrohen dhe administrohen si pjesë e Regjistrit Elektronik të Kujdestarisë Familjare, të integruar në regjistrin e shërbimeve sociale, me qëllim transparencën, gjurmueshmërinë dhe monitorimin.

*Informimi dhe raportimi (Neni 5):* Përcaktohet detyrimi i njësive të vetëqeverisjes vendore për të informuar dhe raportuar Shërbimin Social Shtetëror, përmes Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për familjet kujdestare profesionale dhe për fëmijët në kujdes alternativ në familje që përfitojnë mbështetje financiare. Ky mekanizëm raportimi garanton mbikëqyrjen qendrore dhe konsolidimin e të dhënave për qëllime monitorimi, planifikimi dhe politikëbërjeje.

*Indeksi (Neni 6):* Përcaktohet detyrimi i Shërbimit Social Shtetëror për rishikimin periodik të masave të mbështetjes financiare sipas nenit 2 të këtij vendimi, me qëllim indeksimin çdo vit në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit. Ky mekanizëm siguron ruajtjen e vlerës reale të mbështetjes financiare në kohë dhe parandalon erozionin e mbështetjes financiare për shkak të rritjes së kostos së jetesës.

*Ngarkimi për zbatim (Neni 7):* Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi ministria përgjegjëse për çështjet sociale, ministria përgjegjëse për financat, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

*Hyrja në fuqi (Neni 8):* Përcaktohet hyrja në fuqi e projektvendimit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si autoriteti politikëbërës përgjegjës për fushën;
- Ministria e Financave për sigurimin e fondeve buxhetore për zbatimin e këtij vendimi;
- Shërbimi Social Shtetëror dhe Drejtoritë Rajonale të tij, për mbledhjen, konsolidimin dhe monitorimin e të dhënave, si dhe për administrimin e Regjistrit Elektronik të Kujdestarisë Familjare të integruar në regjistrin e shërbimeve sociale;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për lidhjen e kontratave të punës me prindërit aplikues të familjeve kujdestare profesionale, kryerjen e pagesave të përcaktuara në këtë projekakt dhe informimin/raportimin periodik te Shërbimi Social Shtetëror.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është përgatitur nga drejtoria përgjegjëse për politikën e kujdesit shoqëror në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 92/2025, “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektvendim dërgohet për mendime institucioneve të mëposhtme: Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrin të Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrin të Shtetit dhe Kryenegociatorit, Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektvendimi parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit, pasi përcakton masat e mbështetjes financiare mujore dhe vjetore për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje, si dhe pagën mujore për familjet kujdestare profesionale.

Shpenzimet për zbatimin e këtij projektakti akordohen dhe përballohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe programet buxhetore përkatëse. Në këtë analizë u vlerësuan shpenzimet vjetore për periudhën trivjeçare 2026-2028 në një format, i cili orienton institucionet publike në planifikimin e buxhetit.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për masën e pagesës për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje dhe për familjen kujdestare”.

sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), përveç pagesës mujore dhe vjetore që familja merr për çdo fëmijë në kujdesin e tyre.

Niveli i mbështetjes financiare mujor për kujdestarët profesionalë është i barabartë me pagën minimale në fuqi. Shpenzimet e përgjithshme për paketën financiare për kujdestarët profesionalë arrijnë në 42 milionë lekë në vit për 60 familjet kujdestare në vitin e parë (2026) të zbatimit të ligjit, kur parashikohet të angazhohen më shumë se një e dyta e numrit indikativ të përgjithshëm të familjeve kujdestare të specializuara (140 familje), deri në 98 milionë lekë në vit nga viti i dytë (2027), kur parashikohet të arrihet kapaciteti maksimal.

Niveli i pagesës mujore për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alternativ propozohet në nivelin 12,000 lekë për çdo fëmijë dhe një pagesë vjetore në masën 35,000 lekë për shpenzime të tjera, të cilat propozohen të indeksohen çdo vit.

Shpenzimet për këto zëra përlogariten në rreth 27.7 milionë lekë në vit për vitin e parë të zbatimit të ligjit dhe rriten deri në 53.2 milionë lekë në vit në vitin fundor të PBA-së (2028), për shkak të rritjes së numrit të fëmijëve dhe indeksimit vjetor të pagesave (2% indikative).

Këto shpenzime mbulohen nga programi 10430 “Përkujdesja sociale”.

#### PROPOZUESI

#### MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

EVIS SALA

